

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar

P5

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

*Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme*

Data 21.09.2024

1. Më poshtë janë paraqitura Pasqyrat e Pozitës Financiare më 31 dhjetor 2023 të Jordan sh.a James sh.a:

	<b>Jordan sh.a</b>	<b>James sh.a</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	37,000	30,000
Prona investuese	5,000	-
Investimet	<u>24,000</u>	<u>-</u>
	66,000	30,000
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	9,000	8,000
Llogaritë e arketueshme tregtare	11,000	10,000
Paraja	<u>10,000</u>	<u>4,000</u>
	<u>30,000</u>	<u>22,000</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>96,000</b>	<b>52,000</b>
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e zakonshme (€2.50 secila)	20,000	8,000
Fitimet e mbajtura	<u>26,000</u>	<u>16,000</u>
	46,000	24,000
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
10% kredi bankare	11,900	12,000
<i>Detyrimet afatshkurtra</i>		
Llogaritë e pagueshme	<u>38,100</u>	<u>16,000</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>96,000</b>	<b>52,000</b>

#### **Informata shtese:**

- i) Më 1 janar 2022, Jordan sh.a bleu 2.4 milionë aksione të zakonshme të James sh.a kur saldo e fitimeve të mbajtura të James sh.a ishte €11 milionë. Nuk kishte asnjë ndryshim në kapitalin aksionar që nga blerja. Si pjesë e konsideratës së dhënë në blerje për aksionet e blera, aksionerët e James sh.a pranuan 1 milion aksione me vlerë €7 milion në Jordan sh.a. dhe një shumë prej €12.1 milion të paguhet më 31 dhjetor 2023. Vlera e tanishme e €1 bazuar në normen e skontimit 10% e cila u konsiderua si një normë e përshtatshme skontimi për Jordan sh.a, janë si më poshtë:

<b>Viti</b>	<b>Vlera e tanishme €1</b>
1	€0.90909
2	€0.82645

Regjistrimet e blerjes së aksioneve ishin regjistruar në mënyrë korrekte për efektet e të gjitha sa më sipër, duke përfshirë çdo anulim të skontimit, me përjashtim të pagesës përfundimtare të bërë më 31 dhjetor 2023 e cila është përfshirë në llogaritë e pagueshme.

- ii) Në momentin e blerjes, vlerat e drejta të pasurive, detyrimeve dhe kontingjencave të James sh.a ishin të barabarta me vlerat kontabël të tyre, me përjashtim të pasurive të mëposhtme:

	Shuma bartëse €'000	Vlera e drejtë €'000
Llogaritë e arketueshme tregtare	1,250	850
Stoqet	1,500	900
Pronat	14,000	17,000

Pronat kishin një jetë të dobishme të mbetur prej 10 vjetësh. Asnjë zë i pronave nuk është shitur gjatë dy (2) viteve deri më 31 dhjetor 2023. Stoqet dhe llogaritë e arketueshme tregtare janë realizuar gjatë periudhës pas blerjes.

- iii) Më 1 janar 2023, James sh.a i shiti Jordan sh.a një fabrikë për €5 milionë. James sh.a fillimisht e bleu fabrikën për €6 milionë dhe James sh.a e kishte zhvlerësimin e akumuluar prej €2.2 milionë deri në datën e shitjes. James sh.a konsideroi se fabrika një jetë të dobishme të mbetur prej pesë (5) vitesh në datën e shitjes.
- iv) Prona investuese në librat e Jordan sh.a përfaqëson një objekt zyre që u përfundua në 1 janar 2022 me një kosto prej €3.5 milion. Jeta e dobishme ekonomike e objektit u vlerësua në 20 vjet. Menjëherë pas blerjes së James sh.a-së, Jordan sh.a filloi t'i jepte me qira këtë pronë James sh.a-së nën një marrëveshje qiraje. Grupi Jordan sh.a vlerëson pronat e tij investuese duke përdorur modelin e vlerës së drejtë sipas SNK 40 *Pronat Investuese* dhe pronat e tij të zotëruara nga pronarët duke përdorur modelin e kostos sipas SNK 16 *Prona, fabrika dhe pajisjet*.
- v) Më 1 janar 2023, Jordan sh.a bleu 30% të aksioneve të zakonshme të Abdul-Jabbar sh.a me një kosto prej €6 milionë. Gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2023, Abdul-Jabbar sh.a raportoi një fitim pas tatimit prej €2 milionë. Asnjë dividend nuk është paguar apo deklaruar nga Abdul-Jabbar sh.a gjatë periudhës. Në fund të vitit, stoqet e Abdul-Jabbar sh.a-së përfshinin €1.2 milionë mallra të blera nga Jordan sh.a gjatë vitit deri me 31 dhjetor 2023. Jordan sh.a ngarkon një marzhe prej 25% në çmimin e shitjes në të gjitha shitjet.
- vi) Më 31 dhjetor 2023, zërit të mirë në James sh.a iu atribua me një humbje nga dëmtimi prej €0.5 milion.
- vii) Është politike e grupit të vlerësoj interesin jo-kontrollues sipas pjesës proporcionale të (vlerës së drejtë) të pasurive neto të identifikueshme të degës (filialit).

**Kërkohet:**

**Përgatiteni Pasqyren e Konsoliduar të Pozitës Financiare të grupit Jordan sh.a me 31 dhjetor 2023.**

**(30 pikë)**

**Grupi Jordan sh.a**  
**Pasqyra e Konsoliduar e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2023**

	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Prona, fabrika dhe paisjet (L17)	71,590
Prona investuese (5,000-3,500-1,500)	-
Investimet (24,000-17,000-6,000)	1,000
Zëri i mirë (L13)	750
Investimi në shoqëri (L16)	<u>6,510</u>
	79,850
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Stoqet (9,000+8,000)	17,000
Llogaritë e arkëtueshme (11,000+10,000)	21,000
Paraja (10,000+4,000-12,100)	<u>1,900</u>
	39,900
<b>Total pasuritë</b>	<b>119,750</b>
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>	
Aksionet e zakonshme	20,000
Fitimet e mbajtura (L15)	<u>27,490</u>
	47,490
Interesi jo-kontrollues (L14)	<u>6,360</u>
	53,850
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
10% kredi bankare (11,900+12,000)	23,900
<i>Detyrimet afatshkurtra</i>	
Llogaritë e pagueshme (38,100+16,000-12,100)	<u>42,000</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>119,750</b>

**Llogaritjet**

1. Struktura e grupit Jordan sh.a

2.4 milion aksione ÷ 3.2 milion aksione = 75 % grupi dhe 25% IJK

**2. Neto pasuritë e James sh.a**

	Data e blerjes €'000	Data e raportimit €'000	Pas blerjes €'000
Aksionet e zakonshme	8,000	8,000	-
Fitimet e mbajtura	11,000	16,000	5,000
Llogaritë e arketueshme tregtare (1,250 - 850)	(400)	-	400
Stoqet (1,500 - 900)	(600)	-	600
Prona (17,000 - 14,000)	3,000	3,000	-
Zhvlerësimi shtesë në prona (3,000 ÷ 10 x 2)	-	(600)	(600)
FPR në shitjen e fabrikës [(5,000 - (6,000 - 2,200)]	-	(1,200)	(1,200)
Korigjim i shverësimit – shitja e fabrikës (1,200 ÷ 5)	-	<u>240</u>	<u>240</u>
	<b>21,000</b>	<b>25,440</b>	<b>4,440</b>

<b>3. Zëri i mirë</b>	<b>€'000</b>
Kosto e investimit:	
Këmbimi i aksioneve	7,000
Pagesa në para e shtyrë (12,100 x 0.82645)	<u>10,000</u>
	17,000
Pjesa e pasurive neto në blerje të filialit që i takon grupit L12 (75% x 21,000)	<u>(15,750)</u>
Zëri i mirë në blerje me 1 janar 2021	1,250
Humbja nga dëmtimi	<u>(500)</u>
<b>Zëri i mirë në datën e raportimit</b>	<b>750</b>
<b>4. Interesi jo-kontrollues</b>	<b>€'000</b>
Pjesa e pasurive neto të filialit në blerje, L12 (21,000 x 25%)	5,250
Pjesa e levizjeve në pasuritë neto të filialit pas blerjes L12 (4,440 x 25%)	<u>1,110</u>
IJK në datën e raportimit	<b>6,360</b>
<b>5. Fitimet e mbajtura të grupit</b>	<b>€'000</b>
Jordan sh.a	26,000
Anulimi i fitimit nga VD në pronën investuese (5,000-3,500)	(1,500)
Zhveleresimi i pronës (si e prdorur nga pronari, 3,500 ÷ 20 x 2 vite)	(350)
FPR nga shitja te shoqëria (30% x 25% x 1,200)	(90)
Pjesa e fitimeve të filialit pas blerjes (75% x 4,440)	3,330
Humbja nga demtimi	(500)
Pjesa e fitimeve të shoqërisë pas blerjes (30% x 2,000)	<u>600</u>
	<b>27,490</b>
<b>6. Investimi në shoqëri</b>	<b>€'000</b>
Kosto e investimit	6,000
Pjesa e fitimeve pas blerjes së shoqërisë (30% x 2,000)	600
FPR në mallra (30% x 25% x 1,200)	<u>(90)</u>
Investimi në shoqëri në datën e raportimit	<b>6,510</b>
<b>7. Prona, fabrika dhe paisjet</b>	<b>€'000</b>
PFP e Jordan sh.a	37,000
PFP e James sh.a	30,000
Ndryshimet ne VD (17,000 - 14, 000)	3,000
Minus Zhvelersimi shtese (3,000 ÷ 10 x 2)	(600)
Prona investuese e kontabilizuar sipas SNK 16	3,500
Minus zhveleresimi i prones me siper (3,500 ÷ 20 x 2)	(350)
FPR ne fabriken e shitur (5,000 - 6,000 +2,200)	(1,200)
Shto korigjim i zhveleresimit ne FPR (1,200 ÷ 5)	<u>240</u>
	<b>71,590</b>

\*Sipas SNK 40 Prona investuese, prona e dhënë me qira një mëmë, filiali ose filiali tjetër nuk është pronë investuese në pasqyrat financiare të konsoliduara që përfshijnë si qiradhënësin ashtu edhe qiramarrësin, sepse prona është pronë e përdorur nga pronari nga këndvështrimi i grupit. Prandaj, prona do të paraqitet si Pronë, Fabrikë dhe Pasije.

2.

a) Malone sh.a është një kompani publike që operon në Kosovë dhe është e vendosur në Rajonin Verior të Kosovës. Kompania operon në sektorin e prodhimit. Malone sh.a përgatit pasqyrat e saj deri më 31 dhjetor të çdo viti.

Gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2023, Malone sh.a ndërtoi një zyrë qendrore në Mitrovicë. Kostot që lidhen me ndërtimin e zyrës qendrore janë si më poshtë:

	€'milion
Tarifat për lejet mjedisore dhe lejet e ndërtimit	0.5
Blerja e tokës	10.0
Tarifat e arkitektit dhe inxhinierit	1.0
Materialet e ndërtimit dhe kostot e punës (përfshirë materialet e papërdorura)	6.5
	18.0

Më 31 gusht 2023, data kur zyra qendrore u bë e disponueshme për përdorim, kostoja e materialeve të papërdorura në vendpunishte arriti në €0.5 milion. Në atë datë, kostot totale të huamarrjes të shkaktuara për një hua e cila u përdor për financimin specifik të ndërtimit të zyrës qendrore arriti në €0.8 milion. Jeta e dobishme e parashikuar e ndërtesës ishte 40 vjet.

**Kërkohet:**

**Duke iu referuar SNRF-ve, përcaktoni koston fillestare që do të kapitalizohet, ngarkesën e zhvlerësimit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023 dhe vlerën kontabël të zyrës qendrore më 31 dhjetor 2023.** (6 pikë)

(b) Ekzistojnë shumë arsye për bizneset që të operojnë si grupe; për goodwill-in e shoqëruar me emrin e degëve, për qëllime tatimore apo ligjore e të tjera. SNRF 10 kërkon nga kompania prind që të prezantojë pasqyrat financiare të konsoliduara. Kur një kompani prind publikon pasqyrat financiare të konsoliduara, ajo duhet t'i konsolidojë të gjitha degët, edhe të jashtme edhe të vendit.

**Kërkohet:**

**Përshkruani katër (4) rrethana në të cilat një kompani prind nuk mund t'i kërkohet të rezantojë pasqyrat financiare të konsoliduara sipas SNRF 10 Pasqyrat financiare të konsoliduara.** (4 pikë)

2.

a)

**Malone sh.a**

	<b>€'million</b>
Blerja e tokës	10.0
Tarifat për lejet mjedisore dhe lejet e ndërtimit	0.5
Tarifat e arkitektit dhe inxhinierit	1.0
Materialet e ndërtimit dhe kostot e punës	6.5
Materialet e papërdorura	(0.5)
Kostot e huamarrjes	<u>0.8</u>
Kostot fillestare që duhet të kapitalizohen	18.3000
Zhvlerësimi $(18.3/40 \times 4/12)$	<u>(0.1525)</u>
<b>Vlera kontabel me 31 dhjetor 2023</b>	<b>18.1475</b>

b)

Kompania prind nuk duhet të prezantojë pasqyrat financiare nëse dhe vetëm nëse vlen njëra nga të mëposhtmet:

- a) Vetë kompania prind është një degë në pronësi të plotë, ose është në pronësi të pjesërishtme nga një entitet tjetër dhe pronarët tjerë të saj, duke përfshirë edhe ata që nuk kanë të drejtë vote, që janë të informuar dhe nuk kundërshtojnë që kompania prind të mos prezantojë pasqyrat e konsoliduara financiare.
- b) Letrat e saj me vlerë nuk tregtohen publikisht.
- c) Nuk është në procesin e lëshimit të letrave me vlerë në tregjet publike të letrave me vlerë; dhe.
- d) Kompania prind përfundimtare dhe e ndërmjeme publikon pasqyrat e konsoliduara financiare që janë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

3. O'Neal sh.a ka qenë në funksion për pesë vitet e fundit. Si një entitet i listuar në bursë, kompania përdor SNRF të plota në përgatitjen e pasqyrave të saj financiare. Menaxhmenti i kompanisë është duke përgatitur pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 dhe ka nxjerr bilancin e mëposhtëm provues për periudhën:

	<b>Debi</b>	<b>Kredi</b>
	<b>€</b>	<b>€</b>
Të hyrat		1,171,000
Stoqet (31 dhjetor 2022)	80,000	
Blerjet	543,000	
Shpenzimet administrative	180,000	
Shpenzimet e marketingut dhe shpërndarjes	55,000	
Pasuritë jo-qarkulluese (kosto) - 31 dhjetor 2022: shënim (ii)		
Mobilje dhe pajisje	88,000	
Mjetet motorike	180,000	
Paisjet e zyrës	30,000	
Pasuritë e patrupëzuara	50,000	
Zhvlerësimi i akumuluar - 31 dhjetor 2022: shënim (ii)		
Mobilje dhe pajisje		18,000
Mjetet motorike		62,400
Paisjet e zyrës		13,000
Pasuritë e paprekshme		6,000
Llogaria e tatimit - shënim (iii)	28,000	
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	151,000	
Të pagueshmet tregtare		125,000
Tatimi i shtyrë- 31 dhjetor 2022: shënim (iii)		21,000
13% Fletëobligacion - shënim (iv)	19,000	
Të ardhurat nga interesi - shënim (iv)		2,600
Paraja në bankë - shënim (v)	283,000	
Kapitali aksionar		200,000
Fitimet e mbajtura		<u>68,000</u>
	<u>1,687,000</u>	<u>1,687,000</u>

**Informacioni shtesë i mëposhtëm është i rëndësishëm në përgatitjen e pasqyrave financiare të kompanisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023:**

- i) Stoqet me 31 dhjetor 2023 u vlerësuan në €65,000.
- ii) Më 1 nëntor 2023, një nga automjetet e O'Neal sh.a-së që përdorej për shitjen dhe shpërndarjen e produkteve të gatshme u përfshi në një aksident. Si pasojë e aksidentit automjeti është dëmtuar rëndë përtej riparimeve. Ky automjet është blerë nga kompania më 1 janar 2021 për €95,000. O'Neal sh.a, megjithatë, e ka siguruar automjetin dhe kështu më 4 nëntor 2023 i ka shkruar kompanisë së sigurimit për kërkesën, për blerjen e një automjeti të ri. Si përgjigje, kompania e sigurimeve zgjodhi dhe vlerësoi makinën e dëmtuar dhe më 8 janar 2024 i pagoi kompanisë një kërkesë prej €80,000. Nuk ka pasur ndryshime të tjera në pasuritë jo-qarkulluese për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.



Pasuritë jo-qarkulluese zhvlerësohen ose amortizohen si më poshtë:

- Mobilje & pajisje - 20% të kostos
- Pajisjet e zyrës, automjetet dhe pasuritë e paprekshme - 10% e kostos

Asnjë zhvlerësim nuk ngarkohet për pasuritë jo-qarkulluese në vitin e çnjohjes. Shpenzimet e zhvlerësimit ose amortizimit i ngarkohen kostos së shitjeve.

- iii) Llogaria e tatimit përfaqëson shumën e përgjithshme të paguar nga kompania si tatim i vetëvlerësuar mbi fitimin e saj të vlerësuar për katër tremujorët e vitit 2023. O'Neal sh.a në vitin 2023, kishte zyrtarë të Autoritetit të Administratës Tatimore duke audituar të dhënat e saj tatimore për vitet e vlerësimit 2021 dhe 2022. Të gjitha vitet e mëparshme para vitit 2021 të vlerësimit tashmë janë audituar nga Autoriteti i Administratës Tatimore. Raporti i auditimit i Autoritetit të Administratës Tatimore i marrë dhe i rënë dakord nga O'Neal sh.a në nëntor 2023 zbuloi sa vijon:

<b>Viti i vlerësimit</b>	<b>Tatimi aktual i llogaritur për vitin</b>	<b>Detyrimi tatimor sipas auditimit për tatime</b>
	<b>€</b>	<b>€</b>
2021	45,000	43,000
2022	57,800	67,600

O'Neal sh.a ka paguar plotësisht tatimin aktual për vitet 2021 dhe 2022 në gjysmën e parë të viteve 2022 dhe 2023 përkatësisht. Megjithatë, diferencat që rrjedhin nga kontrolli tatimor nuk janë përfshirë në bilanci e mësipërme dhe janë ende për t'u paguar nga kompania. Shpenzimet e tatimit aktual dhe rritja e detyrimit tatimor të shtyrë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 janë vlerësuar respektivisht në €35,300 dhe €3,750.

- iv) Si pjesë e menaxhimit të rrjedhave të parasë, O'Neal sh.a në fillim të vitit aktual, bleu një obligacion 5-vjeçar me kupon vjetor 13%, vlerë nominale €20,000 menjë çmim prej €19,000, me tarifë brokerimi prej 2% të vlerës nominale. Obligacioni do të shlyhet me një premi prej 5% mbi vlerën e tij nominale. Tarifa e paguar e ndërmjetësimit është përfshirë në shpenzimet administrative. Modeli i biznesit të O'Neal sh.a në lidhje me këtë obligacion është ta mbajë atë deri në maturim, dhe mund ta shesë kur ka një mundësi të mirë për ta bërë këtë. Norma efektive e interesit të obligacionit është 15% dhe vlera e drejtë e saj më 31 dhjetor 2023 është €21,000.

- v) Llogaria bankare paraqet gjendjen e librit të parave të gatshme më 31 dhjetor 2023. Megjithatë, pasqyra bankare zbulon një gjendje prej €353,000 në këtë datë. Ekzistojnë vetëm dy dallime rakorduese midis dy shifrave:

1. Çeqet e regjistruara në anën e kredisë të librit të parave të gatshme, por që ende nuk janë paraqitur në Bankë për pagesë dhe
2. Tarifat bankare që ende nuk janë regjistruar në librin e parave të gatshme.

Vlera e çeqeve që ende nuk janë paraqitur në bankë për pagesë është €72,000. Të gjitha tarifatat bankare klasifikohen si shpenzime administrative.

**Kërkohe:**

**Përgatitni Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse të O'Neal sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 dhe Pasqyrën e Pozitës Financiare më 31 dhjetor 2023. Trego qartë të gjitha llogaritjet përkatëse (20 pikë)**

## 3.

## O'Neal sh.a

## Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023

	€
Të hyrat	1,171,000
Kosto e shitjes (L17)	<u>(592,100)</u>
Fitimi bruto	578,900
Të ardhurat tjera (L11)	4,000
Shpenzimet administrative (L18)	(181,600)
Shpenzimet e marketingut dhe shpërndarjes	<u>(55,000)</u>
Fitimi para interesit dhe tatimit	346,300
Të ardhurat financiare (L111)	<u>2,910</u>
Fitii para tatimit	349,210
Shpenzimet e tatimit (L13)	<u>(46,850)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>302,360</b>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:	
Ndryshimet në VDTTGj (L111)	<u>1,290</u>
<b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>303,650</b>

## O'Neal sh.a

## Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2023

	€
<b>Pasuritë</b>	
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Prona, fabrika & paisjet (L110)	99,500
Pasuritë financiare (L111)	21,000
Pasuritë e paprekshme (L110)	<u>39,000</u>
	159,500
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Stoqet	65,000
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera (L112)	231,000
Paraja në bankë (L113)	<u>281,000</u>
	<u>577,000</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>736,500</b>
<b>Ekuiteti &amp; detyrimet</b>	
<i>Ekuiteti</i>	
Kapitali aksionar	200,000
Fitimet e mbajtura (L114)	370,360
Rezerva e VDTTGj (L111)	<u>1,290</u>
	571,650
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
Detyrimet e tatimit të shtyrë (L15)	24,750
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
Të pagueshmet tregtare	125,000
Detyrimet e tatimit aktual (L14)	<u>15,100</u>
	<u>140,100</u>
<b>Total ekuiteti &amp; detyrimet</b>	<b>736,500</b>

## Llogaritjet:

### 1. Fitimi ose humbja nga çregjistrimi i pasurisë jo-qarkulluese

Data e aksidentit është 1 nëntor 2023, dhe automjeti në këtë datë është dëmtuar përtej riparimit. Kështu, pasuria çregjistrohet në këtë datë. Meqenëse pasuria është i siguruar, dëmi i arkëtueshëm i sigurimit bëhet përfitimi që rrjedh pas çregjistrimit. Megjithatë, kjo nuk dihej në këtë datë dhe u bë e ditur pas fundit të vitit. Në përputhje me SNK 10 *Ngjarjet pas periudhës raportuese*, pagesa e dëmit nga kompania e sigurimit është një ngjarje korrigjuese dhe për këtë arsye duhet të përdoret në përcaktimin e fitimit ose humbjes me çregjistrimin e pasurisë.

Data e blerjes së pasurisë = 1 janar 2021

Zhvlerësimi =  $10/100 \times €95,000 = €9,500$

Zhvlerësimi i akumuluar =  $2 \text{ vite} \times €9,500 = €19,000$

Asnjë zhvlerësim nuk ngarkohet për pasuritë jo-qarkulluese në vitin e çnjohjes

Vlera bartëse në datën e çnjohjes =  $€95,000 - €19,000 = €76,000$

Kërkesa e sigurimit në fund të vitit nuk është pranuar dhe është regjistruar si më poshtë:

Debi	Kërkesa e arkëtueshme e sigurimit	€80,000
Kredi	Lagimi i pasurisë/çnjohje	€80,000

Aseti është çregjistruar me vlerën kontabël prej €76,000 (d.m.th. kosto prej €95,000 dhe zhvlerësim i akumuluar prej €19,000).

Fitimi pas çnjohjes prej €4,000 ( $€80,000 - €76,000$ ) njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

### 2. Nën/(mbi)provizionimi i tatimit

Viti	Tatimi aktual €	Tatimi i audituar €	Diferenca €
2021	45,000	43,000	(2,000)
2022	57,800	67,600	<u>9,800</u>
			7,800

### 3. Llogaritja e shpenzimeve të tatimit

	€
Tatimi aktual	35,300
Nën provizionimi (L12)	7,800
Tatimi i shtyrë	<u>3,750</u>
	<b>46,850</b>

### 4. Detyrimet e tatimit aktual

	€
Shpenzimet e tatimit aktual	35,300
Tatimi i vetvlerësuar	(28,000)
Nën provizionimi i tatimit	<u>7,800</u>
	<b>15,100</b>

### 5. Detyrimet e tatimit të shtyrë

	€
Saldo në fillim	21,000
F ose H	<u>3,750</u>
	<b>24,750</b>

<b>6. Zhvlerësimi</b>	<b>€</b>
Mobilje dhe pajisje (20/100 x 88,000)	17,600
Mjetet motorike (10/100 x (180,000 -95,000))	8,500
Paisjet e zyrës (10/100 x 30,000)	3,000
Pasuritë e patrupëzuara (10/100 x 50,000)	<u>5,000</u>
	<b>34,100</b>

<b>7. Kosto e shitjes</b>	<b>€</b>
Stoqet në fillim	80,000
Blerjet	548,000
Stoqet në fund	<u>(65,000)</u>
	563,000
Zhvlerësimi (L16)	<u>34,100</u>
	<b>597,100</b>

<b>8. Shpenzimet administrative</b>	<b>€</b>
Saldo sipas bilancit provues	180,000
Tarifat e brokerimit	(400)
Tarifat bankare	<u>2,000</u>
	<b>181,600</b>

<b>9. Tarifat bankare</b>	<b>€</b>
Libri i parave të gatshme	283,000
Çeqet e paparaqitura	<u>72,000</u>
	355,000
Saldo në bankë	<u>353,000</u>
	<b>2,000</b>

<b>10. Prona, fabrika &amp; paisjet</b>	<b>€</b>
Mobilje dhe pajisje (88,000-18,000-17,600)	52,400
Mjetet motorike (180,000-62,400)-76,000-8,500)	33,100
Paisjet e zyrës (30,000-13,000-3,000)	<u>14,000</u>
	<b>99,500</b>
Pasuritë e paprekshme (50,000-6,000-5,000)	<b>39,000</b>

#### 11. Pasuria financiare

Pasuria financiare është një instrument borxhi dhe modeli i biznesit i kompanisë në lidhje me këtë investim është të mbajë obligacionin deri në maturim, por gjithashtu mund ta shesë atë kur ka një çmim të mirë për ta bërë këtë. Në këtë mënyrë, obligacioni matet me vlerën e drejtë nëpërmjet të tjerave gjithëpërfshirëse. Pasuria fillimisht njihet me koston prej €19,400 (19,000 + 400 (kosto emetimi)). Të ardhurat totale neto financiare (tarifat e ndërmjetësimit, të ardhurat nga interesi dhe primi i riblerjes) amortizohen si pasuri e matur me koston e amortizuar. Megjithatë, në fund të vitit pasuria vlerësohet dhe ndryshimet parqiten në të TTGj.

Vitet	Saldo në fillim	Interesi @15%	Kuponi	Saldo në fund	VD në fund	Rezerva TTGj
2021	19,400	2,910	(2,600)	19,710	21,000	1,290

**12. Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera**

	€
Saldo sipas bilancit provues	151,000
Kërkesa e arkëtueshme e sigurimit	<u>80,000</u>
	<b>231,000</b>

**13. Paraja në bankë**

	€
Saldo sipas bilancit provues	283,000
Tarifat bankare	<u>(2,000)</u>
	<b>281,000</b>

**14. Fitimet e mbajtura**

	€
Saldo në fillim	68,000
Fitimi për vitin	<u>302,360</u>
	<b>370,360</b>

#### 4.

a) SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me klientët* është publikuar në maj 2014. Është rezultat i një projekti të përbashkët ndërmjet IASB-së dhe FASB-së për njohjen e të hyrave. SNRF 15 zëvendëson edhe SNK 18 *Të hyrat* edhe SNK 11 *Kontratat e ndërtimit*. Është efektive për periudhat raportuese që fillojnë nga ose pas 1 janar 2017. Sipas SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me klientët* të hyrat njihen dhe maten duke përdorur një model me pesë hapa i cili zbatohet për të hyrat e fituara nga një kontratë me një klient me përjashtime të kufizuara, pavarësisht nga lloji i transaksionit të të ardhurave ose industria.

Lindaboni sh.a filloi riparimin e urës në lumen ibër në Mitrovicë më 1 janar 2023 për një çmim të rënë dakord prej €4.8 milionë. Ura pritët të përfundojë në 30 qershor 2025 dhe klienti kontrollon urën derisa është duke u ndërtuar. Informacioni i mëposhtëm lidhet me ndërtimin e urës më 31 dhjetor 2023.

	€'000
Kostot e shkaktuara deri me datë	4,000
Vlerësimi i kostove deri në përfundim	840
Pagesat e faturuara dhe të pranuar	4,240

Lindaboni sh.a njih të hyrat nga kontratat me klientët bazuar në kostot e bëra deri më datë në raport me kostot totale (Metodat e inputit).

#### **Kërkohet:**

**(i) Identifikoni dhe shpjegoni shkurtimisht pesë hapat që duhet të ndiqen nga entitetet gjatë njohjes së të hyrave në pajtim me SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me klientët*. (6 pikë)**

**(ii) Shpjegoni se si do të kontabilizohet ndërtimi i urës në pasqyrat financiare të Lindaboni sh.a për vitin deri në 31 dhjetor 2023. (4 pikë)**

b) Më 1 janar 2023, Pippen sh.a mori një makinë për prodhimin e rrotave me lizing 4-vjeçar nga Iverson sh.a. Kur blihet me para, pajisja kushton €350,000. Pippen sh.a do të duhet të montojë pajisjet në një platformë të veçantë përpara se ta përdorë atë. Kostoja e ndërtimit të platformës ishte €50,000.

Pagesat vjetore të lizingut janë €95,000 në vit të pagueshme në fund të vitit. Norma e interesit e nënkuptuar në lizing është 10%. Pajisja ka një jetë të dobishme ekonomike prej 5 vjetësh.

#### **Kërkohet:**

**Shpjegoni dhe tregoni me anë të ekstrakteve se si do të kontabilizohet lizingu në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. (10 pikë)**

a)

(i) Sipas SNRF 15 të hyrat njihen dhe maten duke përdorur një model me pesë hapa.

#### Hapi 1 Identifiko kontratën me klientin.

Një kontratë me klientin është brenda fushëveprimit të SNRF 15 vetëm kur:

- (a) palët në kontratë e kanë miratuar atë dhe angazhohen të përmbushin detyrimet e tyre përkatëse.
- (b) Të drejtat e secilës palë lidhur me mallrat ose shërbimet për t'u transferuar mund të identifikohen.
- (c) Kushtet e pagesës lidhur me mallrat ose shërbimet për t'u transferuar mund të identifikohen.
- (d) Kontrata ka substancë tregtare.
- (e) Është e mundur që entiteti do të arkëtojë konsideratën për të cilën gëzon të drejtën.
- (f) Kontrata mund të jetë e shkruar, verbale ose e nënkuptuar.

#### Hapi 2 Identifiko obligimet për performancë.

Pika kyçe është të dallohen mallrat ose shërbimet. Një kontratë përmban premtime për të furnizuar mallra ose kryer shërbime për një klient. Ato premtime quhen obligime të performancës. Një kompani do të kontabilizoj obligimet e performancës ndarazi vetëm nëse malli apo shërbimi i premtuar është i dallueshëm. Një mall apo shërbim është i dallueshëm nëse shitet ndarazi ose mund të shitet ndarazi sepse ka një funksion të dallueshëm dhe një marzhë të fitimit të dallueshme.

Faktorët që duhet marrë në konsideratë nëse premtimi i entitetit për t'i transferuar mallrat ose shërbimet tek klienti është ndarazi i dallueshëm përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në:

- (a) Entiteti nuk jep një shërbim të rëndësishëm në integrimin e mallit ose shërbimit me mallrat ose shërbimet tjera të premtuara në kontratë.
- (b) Malli apo shërbimi nuk e modifikon ose personalizon në mënyrë të konsiderueshme mallin ose shërbimin e premtuar në kontratë.
- (c) Malli ose shërbimi nuk është shumë i ndërvarur apo shumë i ndërlidhur me mallrat apo shërbimet tjera të premtuara në kontratë.

#### Hapi 3 Përcakto çmimin e transaksionit.

Çmimi i transaksionit është shuma e konsideratës për të cilën pret të ketë të drejtë një kompani në këmbim të transferimit tek klienti të mallrave apo shërbimeve. Çmimi i transaksionit duhet të reflektoj vlerësimin e kompanisë të peshuar në probabilitet të konsideratës së ndryshueshme (përfshirë vlerësime të arsyeshme të shumave kontigjente) si dhe efekteve të rrezikut kreditor të klientit dhe vlerës në kohë të parasë (nëse është materiale).

Shumat kontigjente të ndryshueshme përfshihen vetëm kur është shumë e mundur që nuk do të ketë kthim të të hyrave atëherë kur çfardo paqartësie lidhur me konsideratën kontigjente është qartësuar. Shembuj që mund të krijojnë konsideratë kontigjente përfshijnë: zbritjet, rabatet, rimbursimet, koncesionet e çmimit, kreditimet dhe dënimet.

#### Hapi 4 Aloko çmimin e transaksionit tek obligimet për performancë.



Kur kontrata përmban më shumë se një obligim të dallueshëm për performancë, një kompani alokon çmimin e transaksionit tek të gjitha obligimet e veçanta për performancë në përpjestim me çmimin specifik të shitjes së mallit apo shërbimit për atë obligim për performancë. Nëse malli apo shërbimi nuk shitet ndarazi, kompania duhet të vlerësoj çmimin specifik.

Pra, nëse ndonjë entitet shet një pako të mallrave dhe/ose shërbimeve të cilat gjithashtu i jep edhe pa pako, obligimet e ndara të performancës në kontratë duhet të çmimohen në të njëjtin proporcion si çmimet pa pako. Kjo do të aplikohet tek kontratat e telefonave mobil kur paisja është dhënë 'pa para'. Entiteti duhet të shikoj çmimin specifik për secilën paisje dhe një pjesë e konsideratës së kontratës duhet t'i alokohet paisjes.

Hapi 5 Njihë të hyrat kur të (apo sipas) përmbushen obligimet për performancës. Entiteti përmbush një obligim për performancë duke e transferuar kontrollin e një malli apo shërbimi të premtuar tek klienti. Një obligim për performancë mund të përmbushet në një moment kohor, si p.sh kur mallrat dergohen tek klienti (, ose përgjatë kohës. Një obligim i përmbushur përgjatë kohës do të përmbush një nga kriteret në vijim:

- Klienti merr dhe konsumon njëkohësisht përfitimet përgjatë kohës së përmbushjes së performancës.
- Performanca e entitetit krijon ose përmirëson një pasuri të cilin klienti e kontrollon ndërkohë që pasuria krijohet ose përmirësohet.

**(ii)**

Çmimi i kontratës është €4.8 milionë dhe ka një detyrim të vetëm të performancës, që është ndërtimi i një ure. Detyrimi i ndërtimit do të përmbushet përgjatë kohës dhe për këtë arsye të ardhurat njihen ndërsa kontrata përparon.

Përqindja e përfundimit bazuar në metodën e inuteve është 82.64%(4,000,000/4,840,000), prandaj do të njihen të ardhurat prej €3,966,942 (82.64% x €4,800,000). Gjithashtu kostot e bëra deri më sot prej €4,000,000 do të njihen duke dhënë një humbje të përgjithshme prej €33,058.

Në përgjithësi, projekti pritet të bëjë një humbje prej €40,000 (€4,800,000 - €4,840,000) duke përfshirë humbjen e pritshme të ardhshme prej €6,842 e cila duhet të njihet si provizion në fund të vitit, me kusht që kontrata të përmbushë përkufizimet e një kontrate që krijon humbje sipas SNK 37 *Provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente*.

Në pasqyrën e pozitës financiare, njihet një detyrim i kontratës prej €280,000, i cili përfaqëson tejkalimin e pagesave të faturuara dhe të pranuar.

**Llogaritja**

	€'000
Kostot e shkaktuara deri me datë	4,000
Humbja e parashikuar	<u>(40)</u>
	3,960
Pagesat e faturuara dhe të pranuar	<u>(4,240)</u>
Detyrim i kontratës	280

**b)**

Pippen sh.a si qiramarrëse të njohë një detyrim ndaj lizingut fillimisht në €301,150 në datën e hyrjes në lizing më 1 janar 2023 dhe më pas të njohë një detyrim të ndarë në afatgjate (prej €164,892 dhe detyrim afatshkurtë prej €71,373 në 31 dhjetor 2023. Detyrimi fillestar i Pippen sh.a do të ishte rritur me koston e financimit (interesin e përlllogaritur) për vitin që arrin në €30,115 (10% x €301,150) dhe do të reduktohej nga pagesa prej €95,000.

Për më tepër, Pippen sh.a do të njohë një pasuri me të drejtë të përdorimit në masën fillestare prej €351,150 (€301,150+ €50,000 kosto e platformes). Kjo do të zhvlerësohet për 4 vjet, si më e shkurtëra e afatit të lizingut dhe jetës së dobishme të pasurisë duke dhënë zhvlerësim vjetor prej €87,788 (€351,150/4 vjet) për t'u ngarkuar në fitim ose humbje. Kjo do të ulë koston fillestare të pasurisë me të drejtë të përdorimit në €263,362 (€351,150-€87,788) në pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2023.

**(i) Amortizimi i lizingut**

Në €	Shuma fillestare	Interesi efektiv	Pagesa e lizingut	Saldo ne fund
2023	301,150	30,115	(95,000)	236,265
2024	236,265	23,627	(95,000)	164,892

(ii) Shumat që do të raportohen në Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes për vitin deri më 31 dhjetor 2023

	€
Zhvlerësimi	87,788
Shpenzimet e interesit	30,115

(iii) Shumat që do të raportohen në Pasqyrën e Pozitës Financiare më 31 dhjetor 2023.

*Pasuritë jo-qarkulluese:*

Shuma bartëse = €351,150 - €87,788 = €263,362

Detyrimet afatgjata:

Detyrimi ndaj lizingut €164,892

Detyrimet afatshkurta:

Detyrimi ndaj lizingut €71,373

Llogaritjet tjera:

Kosto fillestare e pasurisë nën lizing:	€
VT e pagesave minimale të lizingut	301,150
Plus kosto e platformes	<u>50,000</u>
Kosto totale	351,150

Zhvlerësimi për 4 vite

$301,150 \div 4 \text{ vite} = €87,788$  në vit

5. Duncan sh.a është një kompani publike në sektorin e transportit. Ajo ofron shërbime transporti në Mitrovicë. Kohët e fundit, menaxhmenti ka vendosur të shtrijë shërbimet e tij në komunat e tjera në veri të Kosovë dhe është zhvilluar një strategji për financimin e autobusëve. Duncan sh.a i është drejtuar një banke lokale për financimin e blerjes së autobusëve. Si rezultat, banka e kontaktuar ka kërkuar një pasqyrë të rrjedhave të parasë për vitin e kaluar që përfundon më 31 mars 2023 për Duncan sh.a.

Detajet e pasqyrave të saj të pozitës financiare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 janë paraqitur më poshtë së bashku me informacione të tjera përkatëse:

**Pasqyra e Pozitës Financiare me:**

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet (shënim ii)	2,200	1,900
Licenca (shënim iii)	<u>1,000</u>	<u>1,275</u>
	3,200	3,175
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Llogaritë e arketueshme tregtare	2,895	1,980
Interesi i arkëtueshëm (shënim i)	13	8
Depozitat afatshkurtra (shënim iv)	80	300
Banka	<u>37</u>	<u>187</u>
	3,025	2,475
<b>Total pasuritë</b>	<b>6,225</b>	<b>5,650</b>
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e zakonshme (€1 secila)	750	500
Premia e aksioneve	150	-
Teprica e rivlerësimit (shënim ii)	280	112
Fitimet e mbajtura (shënim i dhe ii)	<u>2,745</u>	<u>2,912</u>
	3,925	3,524
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
12% kredi bankare	400	375
Tatimi i shtyrë	<u>225</u>	<u>188</u>
	625	563
<i>Detyrimet afatshkurtra</i>		
Llogaritë e pagueshme tregtare	1,325	1,288
Mbitërheqja bankare	312	-
Tatimi aktual	<u>38</u>	<u>275</u>
	1,675	1,563
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>6,225</b>	<b>5,650</b>

**Informacioni i mëposhtëm shtesë është i disponueshëm:**

- i) Draft pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 është si më poshtë:

	<b>€'000</b>
Humbja operative	(80)
Interesi i fituar	30
Kosto financiare	(60)
Humbja para tatimit	(110)
Shpenzimi i tatimit	<u>(3)</u>
<b>Humbja për vitin</b>	<b>(113)</b>

- ii) Prona, fabrika dhe paisjet

	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2023		Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2022	
	Toka dhe ndërtesa	Fabrika dhe Paisjet	Toka dhe ndërtesa	Fabrika dhe Paisjet
	€'000	€'000	€'000	€'000
Kosto/vlerësimi	1,500	1,100	1,200	1,113
Zhvierësimi i akm.	<u>(30)</u>	<u>(370)</u>	<u>(200)</u>	<u>(263)</u>
<b>Shuma bartëse</b>	<b>1,470</b>	<b>730</b>	<b>1,050</b>	<b>850</b>

Duncan sh.a rivlerësoi vlerën kontabël të tokës dhe ndërtesave të saj me një rritje prej €175,000 më 1 janar 2023.

Më 31 dhjetor 2023, Duncan sh.a transferoi €7,000 nga rezerva e rivlerësimit në fitimet e pashpërndara që përfaqësojnë realizimin e rezervës së rivlerësimit për shkak të zhvierësimit të ndërtesave. Shpenzimet e zhvierësimit të ndërtesave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 ishin €30,000. Gjatë vitit, Duncan sh.a bleu një fabrikë të re me një kosto prej €150,000 dhe shiti një fabrikë të vjetër për €37,500 me një humbje prej €30,000.

- iii) Nuk kishte blerje apo shitje të licencave.
- iv) Depozitat afatshkurtra plotësojnë përkufizimin e ekuivalentëve të parasë.

**Kërkohet:**

Përgatitni një pasqyrë të rrjedhave të parasë për Duncan sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 në pajtim me SNK 7 Pasqyra e rrjedhave të parasë duke përdorur metodën indirekte. (20 pikë)

**Pasqyra e rrjedhave të parasë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023***Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative:*

	<b>€'000</b>
Humbja para tatimit	(110)
Korigjo për:	
Interesin e fituar	(30)
Kosto financiare	60
Shpenzimet e zhvlerësimit (L11) (30 + 202.5)	232.5
Humbja nga shitja	30
Amortizimi i licences (1,275-1,000)	<u>275</u>
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet operative para ndryshimeve në KQ	457.5
Rritja në të arkëtueshmet tregtare (2,895-1,980)	(915)
Rënia në të pagueshmet tregtare (1,325-1,288)	<u>37</u>
Paraja e përdorur në operacione	(420.5)
Interesi i paguar	(60)
Tatimi i paguar (L12)	<u>(203)</u>
<b>Neto paraja e përdorur në aktivitetet operative</b>	<b>(683.5)</b>

*Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese:*

Paraja për të blerë PFP (L11) (275 + 150)	(425)
Arkëtimet nga shitja e fabrikës	37.5
Interesi i arkëtuar (L13)	<u>25</u>
<b>Neto paraja e përdorur në aktivitetet investuese</b>	<b>(362.5)</b>

*Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese:*

Arkëtimet nga shitja e aksioneve (750+150-500)	400
Kredia e pranuar (400-375)	25
Dividenda e paguar (L14)	<u>(61)</u>
<b>Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>	<b>364</b>

Neto zvogëlimi në paranë dhe ekuivalentët e parasë	(682)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim (L15)	487
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund	(195)

**Llogaritjet****1. Prona, Fabrika dhe Paisjet:**(a) Toka dhe ndërtesa:

Shuma bartëse saldo në fund	1,470
Plus shpenzimet e zhvlerësimit	30
Minus shuma bartëse saldo në fillim	(1,050)
Minus teprica e rivlerësimit	<u>(175)</u>
Blerja në para (saldo balancuese)	275

(b) Fabrika dhe Paisjet:

Shuma bartëse e fabrikës së shitur:	
Shitja	37.5
Humbja në shitje	<u>30</u>
Shuma bartëse	67.5

(c) Ngarkesa e zhvlerësimit të fabrikës:

Shuma bartëse saldo në fillim	850
Plus blerja në para e fabrikës	150
Minus shuma bartëse e fabrikës së shitur	(67.5)
Minus shuma bartëse saldo në fund	<u>(730)</u>
Ngarkesa e zhvlerësimit (saldo balancuese)	202.5

**2. Tatimi i paguar:**

Tatimi i shtyrë saldo në fund	188
Tatimi aktual saldo në fund	275
Shenzimet e tatimit për vitin	3
Minus tatimi i shtyrë saldo në fillim	(225)
Minus tatimi aktual saldo në fillim	<u>(38)</u>
<b>Tatimi i paguar</b>	<b>203</b>

**3. Interesi i arkëtuar**

Interesi i arkëtueshem saldo në fund	8
Plus interesi i fituar	30
Minus interesi i arkëtueshem saldo në fillim	<u>(13)</u>
Interesi i paguar	25

**5. Dividenda e paguar**

Fitimet e mbajtura në fillim	2,912
Minus humbja	(113)
Plus transferi nga rezerva	7
Minus fitimet e mbajtura në fund	<u>2,745</u>
Dividenda e paguar (saldo balancuese)	<u>(61)</u>

**5. Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim dhe në fund**

	<b>2023</b>	<b>2022</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Depozitat afatshkurta	80	300
Banka	37	187
Mbitërheqja bankare	<u>(312)</u>	<u>0</u>
	<b>(195)</b>	<b>487</b>